



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2023 – 2031 me 01Nr.182/24 i datës 30.01.2024, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më datë 23.07.2026, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Bellacerkë

1. Miratohet vendimi i Kuvendit Komunal me Nr. Prot. 01Nr.172/26 i datës 23.07.2026, për **caktimin** e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Bellacerkë.
2. Lokacioni për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Bellacerkë do të jetë në parcelën kadastrale Nr.00847-2, sipas certifikatës së pronësisë, P-71510002-00847-2, të datës 23.07.2026 me sipërfaqe të përgjithshme prej 1800 m² (Njëmijë e tetëqind metra katror), Zona Kadastrale Bellacërk e evidentuar në posedim të Komuna e Rahovecit.
3. Parcela e cekur në pikën 2 të këtij vendimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2023-2031 me Nr.Prot.01Nr.182/24 i datës 30.01.2024 ka destinim: **333. Shërbime shëndetësore dhe shoqërore.**
4. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit, shfrytëzues do të jetë Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
5. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që parcelën kadastrale Nr.00847-2 ta ndaj dhe të formoj parcelë të re me numër të ri, me sipërfaqe 18 ari, si dhe të bëjë regjistrimin e gjendjes në librat kadastral.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivi.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. 172/26

Më datë: 23.07.2026

Fatmir Iska
Kryesues i Kuvendit

